



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 261, Datë 28.12.2020

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 179, DATË
08.11.2017, “MBI ÇERTIFIKIMIN E SHOQËRISË “OPERATORI I KOMBINUAR I
GAZIT NATYROR” ALBGAZ SH.A.” , I NDRYSHUAR.**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; neneve 37, 50, 59, 68, dhe 80, të ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar; nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; neneve 6-11, të “Rregullores për Certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror”, miratuar me vendimin e Bordit Nr. 100, datë 05.08.2015, ndryshuar me vendimin e Bordit Nr. 129, datë 31.10.2015; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 142/3 Prot, datë 24.12.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 179, datë 08.11.2017,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin Nr. 109, datë 02.07.2020, vendosi:
 1. Pika 2, e Vendimit nr. 221, datë 20.12.2019, ndryshon si më poshtë: - Shoqëria “Albgaz” sh.a., të dorëzojë për miratim në ERE deri në datën 20.12.2020, Programin e përputhshmërisë të përshtatur sipas atij të miratuar nga ERE me vendimin Nr.77, datë 26.05.2017 të bordit të ERE-s, “Mbi miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror”.
 2. Pika 5 dhe 6, bëhen pika 5 me këtë përmbajtje: - Shoqëria “Albgaz” sh.a., të marrë masa për të plotësuar kushtin e vendosur në pikën 5.2, të vendimit Nr. 179, datë 08.11.2017, brënda datës 20.12.2020.
 3. Shoqëria “Albgaz” sh.a., të depozitojë në ERE deklaratat e audituesve financiare të shoqërisë çdo vit ushtrimor.

- Kjo shtyrje u miratua për shkak të pamundësisë së “Albgaz” sh.a. për të përmbushur të gjitha kushtet brenda afatit të përcaktuar në vendimin Nr. 179, datë 08.11.2017, “Mbi certifikimin e shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror” Albgaz sh.a..
- Sa i përket kushtit të vendosur në pikën 4 të vendimit të Bordit të ERE-s Nr. 179/2017, i ndryshuar, që lidhet me depozitimin në ERE për miratim të Programit të Përputhshmërisë, shoqëria ALBGAZ sh.a., ka depozituar në ERE-s këtë program (të përshtatur sipas atij të miratuar nga ERE me vendimin 77/2017), pra dokumentacionin e plotë dhe shterues lidhur me këtë pikë. Duke plotësuar në këtë mënyrë kushtin e vendosur në pikën 4, të vendimit të Certifikimit nr. 179/2017, i ndryshuar.
- Për sa i përket kushtit të vendosur në pikën 5.2, të vendimit të Bordit të ERE-s Nr. 179/2020, i ndryshuar, në lidhje me bashkëpunimin ndër-institucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, Neni 11 dhe 46 (10), i Ligjit për Sektorin e Gazit Natyror dhe transferimin e kompetencave tek Ministria e Ekonomisë, shoqëria ALBGAZ sh.a. ka depozituar në ERE shkresën drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me qëllim implementimin e ndryshimeve të nevojshme ligjore në sektorin e gazit natyror, me qëllim përmbushjen e kushteve të vendimit të certifikimit nr. 179/2017. Ky kusht mbetet ende i paplotësuar për shkaqe që nuk varen nga vullneti i shoqërisë “ALBGAZ” sh.a..
- Në pritje të vendimmarrjes nga ana e MIE-s, lidhur me ndryshimet ligjore, si dhe duke marrë në konsideratë situatën e krijuar për shkak të pandemisë COVID-19, shoqëria “ALBGAZ” sh.a. ka paraqitur në ERE kërkesën për shtyrjen e afatit të vendimit të plotësimit të kushteve të vendimit të certifikimit nr. 179/2020, deri në datën 20.06.2021.
- Në konsideratë të sa më sipër, duke qenë se kërkesa e shoqërisë për shtyrje të afatit të depozitimit të dokumentacionit përkatës është depozituar në zbatim të legjislationit në fuqi, përpara përfundimit të afatit të vendosur në vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 109, datë 02.07.2020 dhe duke marrë në konsideratë faktin se shoqëria ka bërë përpjekjet e saj për plotësimin e kushteve të vendimit Nr. 179/2017, i ndryshuar, vlerësojmë se kërkesa e shoqërisë duhet të pranohet.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të shfuqizojë pikën 4, të vendimit të Bordit të ERE-s Nr. 179, datë 08.11.2017 “Mbi certifikimin e shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror” ALBGAZ sh.a.” , i ndryshuar.
2. Shoqëria “ALBGAZ” sh.a. të marrë masa për të plotësuar kushtin e vendosur në pikën 5.2 të vendimit Nr. 179, datë 08.11.2017, “Mbi certifikimin e shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror” ALBGAZ sh.a.” , i ndryshuar, brenda datës 20.06.2021

3. Shoqëria “ALBGAZ” sh.a. të paraqesë në ERE çdo vit ushtrimor informacion mbi pavarësinë e audituesve financiarë.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë MIE, Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë dhe aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI